



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
GJIROKASTËR**



Nr.23/237[58344-00367-21-2017] Akti
Dt.12.06.2018

Nr.21-2018-915(113) Vendimi
Dt.06.06.2018

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë e përberë prej:

GJYQTAR : Pëllumb Vehbi
GJYQTAR : Mirela Iljopullo
GJYQTAR : Arben Dosti

Me sekretare Marjanthi Kosta në Gjykatë në datën 06.06.2018 në seancë gjyqësore publike shqyrtoi çështjen penale Nr. 23/237[58344-00367-21-2017] Akti me :

AKUZUES : Prokuroria e rrethit gjyqësor Gjirokastrë përfaqësuar nga prokurori Julian Çafka .

I PANDEHUR : Hasan Dedaj i biri i Halit dhe File, i dl.06.05.1958 , banues në Tiranë, me arsim të lartë , i pa denuar me parë , hetuar me masë sigurimi detyrim për paraqitje në pol-gjyqësor mbrojtur nga av. Arjan Sotiri dhe Benard Aliko .

AKUZUAR: Për veprën penale “ Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor ” parashikuar nga Neni 290/4 i K.Penal.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi ,
-dëgjoi prokurorin i cili kërkoi : -deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale që akuzohet dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim , Bazuar në nenin 59 të K.Penal Pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë për një periudhë 5 vjet , Ndalimin për të drejtuar automjete për një periudhë 2 vjet dhe kthimin e sendeve të sekuestruara personave përkatës
- dëgjoi të pandehurin dhe mbrojtjen që kërkoi pafajsi

VEREN

Se, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është sjellë për gjykim çështja penale në ngarkim të të pandehurit Hasan Dedaj , i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/4 të K.Penal .
Gjykata konkludoi se, ka juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe kompetencën tokësore, për të gjykuar këtë procedim penal, bazuar Neneve 69, 74, 76 K.Pr.Penale.

ështëja penale e paraqitur për gjykim në ngarkim të pandehurit Hasan Dedaj , do të gjykohet me tre gjyqtarë , bazuar në nenin 13 të K.Pr.Penale, kjo për faktin se vepra penale për të cilin akuzohet i pandehuri, ka të parashikuar si dënim maksimal 20 vjet burgim.

Nga shqyrtimi i çështjes rezultoi se:

Në datën 24.07.2016 në orën 18.00 shërbimet e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë kanë arrestuar në flagrancë shtetasin Hasan Dedaj , i dyshuar për kryerjen e veprës penale të " Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Arestimi i tij është bërë për faktin se në datën 24.07.2016 në aksin rrugor Gjirokastrë –Tepelenë, në vendin e quajtur Kryqëzimi i fshatit Mashkullorë, në orën 14.00 kishte ndodhur një aksident automobilistik , ku ishin përplasur dy automjete, njeri i markës Nissan me targë ZH 7509560 që drejtohej nga shtetasi Irfan Hasani i cili lëvizte me drejtim Tepelenë - Gjirokastrë, me automjetin e markës Benc Mercedes me targë AA 760 LI me drejtues shtetasin Hasan Dedaj, që lëvizte me drejtim Gjirokastrë – Tepelenë. Si pasojë e kësaj përplasje, kanë gjetur vdekjen shtetasja Albana Hasani dhe djali i saj shtetasi i mitur Daeni Dedaj, të cilët ndodheshin në automjetin e markës Benc Mercedes, e llojit fugon, me targë AA 760 LI , dhe djali i shtetasit Irfan Hasani, shtetasi i mitur Luan Hasani i cili ndodhej në automjetin e markës Nissan me targë ZH 7509560. Po kështu si pasojë e këtij aksidenti janë plagosur dhe shtetasit Irfan Hasani , Pajtesa Hasani dhe Leard Hasani në automjetin e markës Nissan me targë ZH 7509560, dhe Hasan Dedaj , Gencian Sherifi , Klejdi Gjyli , Entela Gjyli që ndodheshin në automjetin e markës Benc Mercedes, e llojit fugon, me targë AA 760 LI . Shtetasit e sipër përmendur të plagosur, pasi janë dërguar në Spitalin Rajonal të Gjirokastrës, janë transportuar për ndihmë mjekësore të specializuar në Spitalin e Traumës - Tiranë.

Nga shërbimet e policisë gjyqësore është realizuar këqyrja e vendit të ngjarjes , shoqëruar me fotografitë përkatëse. Nga tabela fotografike e këqyrjes së vendit të ngjarjes ka rezultuar se mjeti Nissan është i goditur në krahun e djathtë të tij pranë gomës së parë. Kjo tregon se mjeti benz me targë AA 760 LI ka ardhur në krahun e djathtë të mjetit Nissan me targë ZH 7509560

Nga ana e policisë gjyqësore është sekuestruar dhe është kqyrrur në cilësinë e provës materiale edhe pamjet filmike të kamerave të sigurisë të një biznesi që gjendej pranë vendit të ngjarjes.

Po kështu është realizuar këqyrja e mjeteve të sekuestruara me cilësinë e provës materiale, këqyrja e kufomave të shtetasës , Albana Hasani , Daeni Dedaj dhe Luan Hasani.

Nga akti i ekspertimit mjeko ligjor numër 49 datë 24.07.2016 , tek viktima Luan Hasani vërehen plagë masive të kokës me thyerje të kapakut të kokës me dalje të trurit dhe shkaku i vdekjes është dëmtimet e trurit . Nga akti i ekspertimit mjeko ligjor numër 50 datë 24.07.2016 tek viktima Albana Hasani vërehen thyerje të kockave të kapakut dhe bazës së kokës , hemorragji nën cipën e trurit dhe shkaku i vdekjes është shoku traumatik .

Nga akti i ekspertimit mjeko ligjor numër 51 datë 24.07.2016 tek viktima shtetasja Daeni Dedaj vërehen thyerje të kockave të kapakut të kokës kontuzion i dy mushkrive çarje e shpretkës dhe mëlçisë dhe shkaku i vdekjes është shoku traumatik.

Nga akti i ekspertimit mjeko ligjor numër 1424 datë 28.07.2016 tek i pandehuri Hasan Dedaj janë konstatuar contuzio capitis et corporis luxacio traumatic coxo femoralis sinister me paaftësi mbi 9 ditë

Nga akti i ekspertimit mjeko ligjor numër 1423 datë 28.07.2016 tek shtetasi Gencian Sherifi politrauma contuzio thoraksi me paaftësi mbi 9 ditë

Nga akti i ekspertimit mjeko ligjor numër 1490 tek shtetasja Entela Gjyli konstatohen thyerje të kockës të krahut të djathtë .

Nga akti i ekspertimit mjeko ligjor numër 1418 tek shtetasi Leandra Aleksandra Hasani konstatohet koma celebrale shëmbje e trurit , shëmbje e pulmonit thyerje e kockës së dorës dëmtime të rrezikëshme për jetën në momentin kur janë shkaktuar dhe konsiderohet plagosje e rëndë .

Nga akti i ekspertimit mjeko ligjor numër 1431 tek shtetasi Pajtesa Hasani konstatohen dëmtime thyerje e kockave të krahut të djathtë , thyerje të kofshës dëmtime të rënda dhe të rrezikëshme për jetën në momentin kur janë shkaktuar .

Për shtetasit Enid Gjyli dhe Irfan Hasani nuk ka të dhëna në Spitalin Ushtarak Tiranë dhe për këtë arsye nuk janë bërë ekepertimet mjeko ligjore

ka aksidenti pasojat janë : vdekja e shtetasve Luan Hasani , Albana Hasani dhe Dzeni Dedja , plagosje e lehtë e dy personave Hasan Dedja dhe Gencian Sherifi dhe plagosja e rëndë të tre personave Entela Gjyli, Leandra Aleksandra Hasani dhe Pajtesa Hasani

Nga akti i ekspertimit toksikologjiko ligjor numër 1332 datë 29.08.2016 tek shtetasi Irfan Hasani nuk janë konstatuar gjurmë të alkoolit

Nga akti i ekspertimit toksikologjiko ligjor numër 1334 datë 29.08.2016 tek i pandehuri Hasan Dedja nuk janë konstatuar gjurmë të alkoolit

Nga akti i ekspertimit Auto teknik i datës 17.03.2017 ka rezultuar se i pandehuri Hasan Dedja i cili drejtonte mjetin me targë AA760LI , ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe konkretisht nenin 141/1 të Ligjit 8378 / 1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Në funksion të hetimeve, janë marrë pamjet filmike të një biznesi ku janë fiksuar edhe momentet e ndodhjes së aksidentit. Nga pamjet rezulton se i pandehuri Hasan Dedja ka humbur kontrollin e mjetit që drejtonte. Ai qarkullonte në sens lëvizje Gjirokastër-Tepelenë dhe pa shkuar tek kryqëzimi i Mashkullorës, humbet kontrollin e mjetit lëviz nga korsia e tij e krahut të djathtë , në korsinë me sens lëvizje të kundërt, del jashtë rrugës dhe hyn përsëri në rrugë, ndërkohë që drejtuesi Irfan Hasani , në kohën që lëvizte në sensin e tij, si rezultat i manovrës së të pandehurit shmanget. Drejtuesi Hasan Dede e manovron mjetin duke tentuar të hyjë në korsinë e tij, ndërkohë që kjo manovër përkon me lëvizjen e mjetit të shtetasit Irfan Hasani dhe mjetet goditen në një pikë në korsinë e mesit, ajo që përdoret nga mjetet që dalin nga kthesa e fshatit Mashkullorë e ikin për në drejtim të Tepelenës.

Lidhur me këtë mekanizëm të qartë, të pasqyruar nga video, është kryer veprimi i rikqyrjes së vendit, duke përcaktuar relativisht edhe distancat mes mjetit të markës Benc Mercedes, e llojit fugon, me targë AA 760 LI të drejtuar nga i pandehuri Hasan Dedja kur shfaqet në video deri tek momenti ku ai ka ndryshuar korsinë dhe ka dalë nga rruga, nga rihyrja në rrugë deri tek pika e goditjes me mjetin e markës Nisan me targë ZH 7509560 që drejtohej nga shtetasi Irfan Hasani.

Janë kryer tre akte ekspertimi, dy në fazën e hetimeve dhe një në gjykim në lidhje me këtë çështje penale.

Sipas kronologjisë së bërjes së akteve , aktekspertimin e parë i kryer nga eksperti Agron Mema ka përcaktuar shpejtësinë e mjeteve, duke ju referuar edhe videos së marrë, sipas formulës së përcaktuar $V = S / t$, duke nxjerrë shpejtësinë mesatare të mjeteve, nga e cila rezulton se mjetet kanë qënë mbi shpejtësinë e lejuara dhe janë përcaktuar në akt , ka kostatuar se të dy drejtuesit kanë shkelur Kodin Rrugor , në veçanti i pandehuri , nenin 139/1,2,3 , nenin 141/1,2 të këtij kodi . Ky aktekspertimi është nxjerrë i pavlefshëm nga prokurori me vendimin e datës 06.12.2016 .

Në aktin e ekspertimit të dytë kryer nga grupi ekspertëve Ing. E.Kazazi , A.Sulçe dhe Sh.Xhetani , kanë aritur në konkluzionin se i pandehuri ka humbur drejtimin e automjetit , pasi një mjet i paidentifikuar shfaqet në rrugë , i prish ekuilibrin duke i zënë korsinë, dhe i pandehuri si rrjedhojë bën manovrën për të ndryshuar korsinë jo në mënyrë të menjëhershme dhe më pas tenton të futet përsëri në rrugë, por goditet në pjesën e ishullit të rrugës . Thelbi i kostatimit është që i pandehuri vepron në kushtet e nevojës ekstreme, pasi nuk ka faj në manovrën e ndryshimit të korsisë dhe më pas ai duhet të futet në rrugë për të evituar pasojat. Nga ana tjetër, sipas këtij akti, të dy drejtuesit janë përpjekur të shmangin aksidentin i cili ka ndodhur gjatë reagimit psikoteknik .

Në gjykim nga ana e gjykatës është urdhëruar riekspertimi së bashku me ekspertet kriminalistik , mbështetur në aktet e fashikullit dhe pamjet e videos së një subjekti privat .

Tek akti i ekspertimit të Ing. A.Janku , E.Jaho dhe I.Qibini datë 08.04.2018 , për të pandehurin është kostatuar shkelja e neneve 152/1-a , neni 38/2 dhe 139/2 të K.Rrugor si dhe për drejtuesin e automjetit Nisan me drejtues shtetasin Irfan Hasani është kostatuar shkelja e nenit 139/1,2,3 , neni 38/2 dhe neni 141/1 të K.Rrugor dhe si shkak determinant , pasoja ka ardhur nga shpejtësia e shtetasit Irfan Hasani , i cili po të ishte me shpejtësi 50 km/h, pasoja nuk do të vinte, por ka devijuar drejtimin e lëvizjes, pasi nga shpejtësia që kishte, nuk mund ta ndalte mjetin pa goditur mjetin që drejtohej nga i pandehuri.

Vendimin e datës 19.03.2017, prokuroria ka vendosur 'Pushimin e pjesshëm të procedimit penal':
- Nën hetim të personit nën hetim Irfan Hasani, duke përcjellë për gjykim vetëm të pandehurit Hasan Dedja.

Faktet e mësipërme u provuan në gjykim me:

- Procesverbali i kqyrjes së vendit të ngjarjes
- Procesverbali i kqyrjes së automjeteve
- Procesverbali i kqyrjes së kufomave
- Procesverbali i kontrollit të automjeteve
- Aktekspertimet mjeko ligjore për viktimat
- Aktekspertimet mjeko ligjore për të dëmtuarit
- Procesverbalet e sekuestrimit të sendeve
- Deklarimet e dëshmitarëve

Mbi faktet dhe rrethanat e mara në seancë, prokuroria kërkoi deklarin fajtor të të pandehurit Hasan Dedja, për veprën penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" parashikuar nga Neni 290/4 i K.Penal, duke arsyetuar se lidhur me ekspertimin e parë, Shkak lidhur me goditjen e mjetit të të pandehurit nuk është arsyetuar saktësisht, pasi të dy mjetet gati takohen në një pikë, dhe mjeti i të pandehurit Hasan Dedja bën manovër më të gjatë për të arritur tek pika e goditjes dhe goditja ndodh për shkak të manovrës së gabuar të mjetit të të pandehurit dhe nuk mundet që gjithë mekanizmi të copëtohet në momentin fundor të aksidentit, pasi ai ka një rrjedhë kazuzale në kohë më të gjatë. Lidhur me ekspertimin e dytë justifikimi i manovrës së të pandehurit nuk qëndron, pasi distanca nga shmangia me mjetin e parë të paidentifikuar deri tek rihyrja në rrugë është e tillë sa i mundësonte frenimin e mjetit, referuar distancës së matur. Gjithashtu, nga pamjet filmike shihet qartë që mjeti i paidentifikuar bën shmangien sepse mjeti i të pandehurit qarkullonte në korsinë e kundërt. Pra, vërtetohet që humbja e kontrollit të mjetit ka ndodhur për faj të të pandehurit Hasan Dedja. Nga ana tjetër, fakti që shtetasi Irfan Hasani devijon automjetin nga korsia e tij dhe jo lëviz në korsi të kundërt, vërtetohet nga pamjet filmike ku ai fillon manovrën e shmangies pasi konstaton pengesën përpara dhe lëvizjet e paparashikuara të mjetit të të pandehurit që i vjen përballë. Lidhur me ekspertimin e tretë, ekspertët thonë se po të qarkullonte me shpejtësi 50 km/h drejtuesi i automjetit Nisan shtetasi Irfan Hasani, aksidenti nuk do ndodhte, por ata thonë edhe se po të mos humbiste kontrollin e mjetit i pandehuri, aksidenti nuk do ndodhte.

Vepra penale e parashikuar nga neni 290 i K.Penal kryhet nga pakujdesia, pasi personi nuk e dëshiron ardhjen e pasojës. Elementët e kësaj forme fajësie janë:

- a) detyrimi për kujdes
- b) cilësitë konkrete të personit për kujdes
- c) lidhja shkakësore në ardhjen e pasojës.

Rezulton se të dy drejtuesit e kanë shkelur detyrimin e kujdesit, pasi mjeti i të pandehurit ka lëvizur në mënyrë të çrregullt, jo të njëtrashme dhe të paparashikueshme. Gjithashtu, mjetet kanë qënë tej shpejtësisë së lejuar. Lidhur me aftësitë e drejtuesve, të dy kanë patur mundësitë të jenë në kushtet e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor. Lidhur me lidhjen shkakësore, në teorinë e së drejtës penale dhe sipas jursipreduncës, pranohet si shkak ai që është i domosdoshëm dhe i drejtpërdrejtë (shkaku i afërt). Shkaqet mund të parashikohen e për rrjedhojë, personi do të përshtasë sjelljen sipas paparashikueshmërisë së rrjedhave kauzale hipotetike. Janë ato shkaqe që diktojnë rastin, pa të cilët pasoja nuk mund të vijë dhe që e fusin në rrjedhën kauzale çdo veprim tjetër. Në rastin konkret, shkelja e limitit të shpejtësisë nga viktimat Irfan Hasani nuk është shkak adekuat në ardhjen e pasojës, pasi veprimi i të pandehurit, Hasan Dede është i paparashikueshëm, manovra e tij është e palexueshme dhe sjellja e tij percerpohet nga një njeri mesatar si burim rreziku. Në këto kushte, ekspertët përcaktojnë pa të drejtë se shpejtësia po të ishte 50 km/h, pasoja do të shmangej, pasi në këtë rast, nisur nga mosparashikueshmëria e drejtimit të lëvizjes së mjetit të të pandehurit, detyrimi për kujdes i shtetasit kosovar nuk fillon me manovrën e hyrjes në rrugë të mjetit Mercedes-Benz të të pandehurit, pasi lëvizja e tij është e paparashikuar. Kjo e ka shtyrë edhe shtetasin kosovar të bëjë manovër instiktive, devijimin duke menduar se mjeti tjetër vjen drejt dhe realisht kjo manovër përceptohet si e tillë. Lëvizjet instiktive në teorinë e së drejtës penale janë përjashtuar nga nocioni i

primit në kuptimin penalo-juridik. Në këtë drejtim shkon edhe parashikimi në Kodin Rrugor, ku përcaktohet se duhet të manovrosh ndaj një rreziku me sistem drejtimi, frenimi, deri në ndalim të plotë. Kjo ka kuptimin që rrezikun mund ta lësh pas edhe me sistem drejtimi, ta shmangësh atë, dhe kjo në të shumën e rasteve është lëvizje instiktive. Mënyrat e shmangies janë alternative dhe jo kumulative. Për rrjedhojë, shkaku determinant në ardhjen e pasojës është veprimi i të pandehurit Hasan Dedja në manovrën e gabuar që bën e që sjell pasojën konkrete.

Në gjykim i pandehuri Hasan Dedja mbajti qëndrim pasiv dhe përfundimisht kërkoi pafajsi për veprën penale që akuzohet, duke pretenduar se shkaku determinant i shkaktimit të aksidentit ka qënë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i mjetit Nisan me drejtues shtetasin Irfan Hasani.

Sa më sipër gjykata çmon se :

Nga tërësia e provave të administruara në seancë gjyqësore rezulton se në datë 24.07.2016 rreth orës 14.00 në afërsi të fshatit Mashkullorë – Gjirokastrë ka ndodhur aksidenti automobilistik, në të cilin janë përfshirë automjetet me drejtues të pandehurin Hasan Dedja dhe shtetasi Irfan Hasani.

Si pasojë e përplasjes kanë gjetur vdekjen tre shtetas, dhe janë plagosur shtatë shtetas të tjerë.

Sipas akteve të ekspertimit administruara në gjykim, gjithë ekspertët kanë konstatuar se të dy drejtuesit e automjeteve kanë pasur shkelje të neneve të Kodit Rrugor.

Sa më sipër gjykata çmon se vepra penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” e parashikuar nga neni 290/4 të Kodit Penal ka ndodhur për shkak determinant, shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor edhe nga drejtuesi i mjetit Mercedes-Benz me targa AA760 LI i drejtuar nga i pandehuri Hasan Dedja dhe duhet të deklarohet fajtor për veprën penale që akuzohet.

Vepra për të cilën akuzohet i pandehuri paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore pasi ka prekur dhe cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor, të përcaktuar në legjislacionin rrugor, siç është dhe Kodi Rrugor, gjithashtu marrëdhëniet juridike për të mbrojtur paprekshmërinë e jetës dhe shëndetin e shtetasve, nga çdo veprim i kundërligjshëm, pasi me veprimet e tij të kundërligjshme, referuar mekanizmit të ngjarjes dhe konkluzioneve të tre akteve të ekspertimit auto-teknik është konstatuar humbja e kontrollit të mjetit tip Mercedes-Benz, drejtuar nga i pandehuri, kalimi në korsinë e kundërt dalja nga rruga, rifutja në rrugë dhe përplasje me mjetin tip Nisan duke shklur Nenet 139 pika 1,2,3 neni 140 pika 1,2 neni 139/1,2,3 të Kodit Rrugor, të ndryshuar.

Nga ana objektive, me veprimet e tij, i gjykuari ka shkelur rregullat e parashikuara nga legjislacioni rrugor, siç është Kodi Rrugor, përkatësisht mjeti i drejtuar prej tij tip Mercedes Benz, ka humbur kontrollin e drejtimit të mjetit, ka ndryshuar korsinë, ka dalë jashtë karrexhatës, ka rihyrë përsëri në rrugë dhe si pasojë ka ndodhur aksidenti.

Subjekti i veprës penale: I pandehuri Hasan Dedja është subjekt i përgjithshëm i kësaj vepre penale, pasi sipas të dhënave në dosje është mbi 14 vjeç, i përgjegjshëm para ligjit penal dhe nuk u konstatua asnjë shkak i parashikuar nga nenet 12/2 dhe 17 të K.Penal, që e përjashton atë nga përgjegjësia penale.

Ana subjektive: Veprimet e të pandehurit janë kryer me dashje, pasi ai me dashje, ka shkelur rregullat e qarkullimit rrugor, pasi ka njohur, ka dëshiruar dhe ka parashikuar pasojat që vijnë nga shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor. Ndërsa pasojat vdekja e tre shtetasve dhe plagosje e shtetasve të tjerë janë nga pakujdesia, në formën e vetëbesimit të tepruar.

Neni 47 i Kodit Penal parashikon se gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj të pandehurit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese”.

Në rastin konkret, ka rezultuar nga provat shkencore se në shkaktimin e aksidentit kanë ndikuar në thelb, disa faktorë shkaktues me shkallë të ndryshme ndikimi:

1-Sjellja e të pandehurit, nën drejtimin e automjetit Mercedes Benz, duke mos respektuar nenin 138/1, 139/1,2,3, 141/1, 143/6 e 152/1 1 gërma “a” dhe 152/3 gërma “c” të Kodit Rrugor

2-Sjellja e shtetasit Irfan Hasani nën drejtimin e automjetit tjetër, tip Nisan, duke qarkulluar mbi shpejtësinë e lejuar, përafërsisht 120 km/orë, në shkelje të nenit 140 pika “1” të Kodit Rrugor, faktorë të cilët nëse nuk do të ishin mund të parandalonin ngjarjen e rrëndë.

Mbi shkaqet e sipërcituara kur në fakt kemi një konkurrim shkaqesh me fuqi të ndryshme shkakësore që kanë përcaktuar aksidentin, gjykata njeh si shkallë determinante e cila ndikoi në shkaktimin e aksidentit, sjelljen të pandehurit Hasan Dedja, pasi mënyra e drejtimit të automjetit nga ana e tij, është një veprim, i cili ka ndikuar në ardhjen e pasojës, pa përjashtuar praninë e shkaqeve të tjera që kanë konkurruar në ardhjen e pasojës. Në kushtet kur prokuroria ka pushuar hetimet për shtetasin Irfan Hasani, gjykata vlerëson se shkalla e ndikimit të faktorëve të tjerë shkakësorë, edhe pse nuk përjashton praninë e fajësisë, nuk mund të shprehet. Në vërtetimin e përgjegjësisë penale gjykimi lidhjes shkakësore që i atribuohet subjektit aktiv të veprës penale, nuk duhet të bëhet i izoluar dhe shkëputur nga konteksti, pa marrë parasysh në masën e duhur edhe faktorët e tjerë ndikues që, edhe pse jo në shkallë determinante, kanë ndihmuar në ardhjen e pasojës.

Përsa i përket caktimit të masës dhe llojit të dënimit të pandehurit, gjykata, i referohet nenit 47 të K.Penal i cili parashikon:

"Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së Përgjithshme të këtij Kodi, kufijtë e dënimit që parashikohet për këtë veprë penale, rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit, shkallën e fajit, pasojat si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese."

-Veprat penale që akuzohet i pandehuri, neni 290/4 i K.Penal, parashikon dënim me burgim deri në 20 vjet.

-Përsa i përket rrezikshmerisë së veprave penale, ajo paraqet rrezikshmëri të madhe dhe ka një përhapje të gjerë në tërë territorin e R.Shqiperise.

-Në lidhje me rrezikshmërinë e të pandehurit, gjykata konkludon se i pandehuri paraqet rrezikshmëri relativisht të ulët.

Neni 48 dhe 49 parashikon rrethanat që lehtësojnë dënimin, duke marrë në konsideratë moshën, personalitetin, rrethanat familjare edhe rrethana të tjera si humbja e familjarëve nga aksidenti, përveç atyre të parashikuara më lart, përsa kohë i quan që justifikojnë lehtësimin e dënimit.

Nisur nga rrezikshmëria relativisht e pakët shoqërore që paraqet i pandehuri dhe rrezikshmëria e lartë që paraqet vepra penale e kryer prej tij në këtë rast, qëndrimin e tij mohues për akuzën në tërësi, Gjykata çmon se pavaësisht pasojave, izolimi i të pandehurit nga shoqëria për një kohë të gjatë do të sillte një dëm të madh në jetën e të pandehurit dhe të familjes së tij si dhe nuk do të ndihmonte në arritjen e qëllimit kryesor të dënimit, edukimin dhe rehabilitimin e tij.

Gjykata çmon se, lloji dhe masa e dënimit, kërkuar nga prokuroria me burgim, është i drejtë, mbështetur në tërësinë e rrethanave, propocionalitetin, në përshtatje me rrezikshmërinë e veprës, të autorit, si dhe rrethanat e tjera, në të cilat është kryer vepra penale.

Gjithashtu Gjykata çmon se, ky lloj dënimi, në përpjesëtim me veprën e kryer, do t'i shërbejë edukimit të të pandehurit, rehabilitimit të tij, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj veprë penale në shoqëri.

Të pa mbështetur në provat e administruara në gjykim e konsideron gjykata pretendimin e mbrojtjes dhe të pandehurit se në veprimet e të pandehurit Hasan Dedja nuk ka shkelje të rregulave të qarkullimit rrugor dhe pasoja ka ardhë si pasojë e shpejtësisë tej normave të lejuara nga drejtuesi i automjetit Nisan shtetasi Irfan Hasani.

Gjithashtu gjykata vëren se neni 393/1,2 të K.Pr.Penale, përcakton mënyrën e disponimit të gjykatës mbi "shpenzimet procedurale", duke nënkuptuar tërësinë e shpenzimeve të parapaguara nga shteti gjatë gjithë procedimit penal, që nga hetimet paraprake deri në dhënien e vendimit nga gjykata. Si rrjedhim, gjykata në këtë vendim përfundimtar, i ngarkon të gjitha shpenzimet procedurale të pandehurit Hasan Dedja.

Për këto arsye

Gjykata bazuar në Nenin 290/4 të K.Penal dhe neni 390 i K. Pr. Penale:

V E N D O S I

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Hasan Dedja për kryerjen e vePRES penale “ Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe bazuar ne nenin 290/4 , dënimin e tij me 6 vjet burgim .
- Vuajtja e dënimit fillon nga data e ekzekutimit të këtij vendimi.
- Shpenzimet proceduriale në ngarkim të të pandehurit .
- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Gjirokastër brënda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij

-U shpall në Gjirokastër, më 06.06.2018

Gjyqtar
Arben Dosti

Sekretare
Marjanthi Kosta

Gjyqtar
Mirela Iljopullo

Gjyqtar
Pellumb Vehbi

Vërtetohet se është e njëjtë me origjinalin
Gjirokastër më 21/06/2020 Kancelare
DONALDA FERUNI



Shënim:

- Kunder vendimit ka bërë ankim i pandehuri Hasan Dedja.
- Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin nr.20-2018-834/105 vendimi, datë 17.10.2018, ka vendosur:
- Ndryshimin e vendimit penal nr.21-2018-915/113, datë 06.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër si më poshtë:
- Deklarimin si të pafajshëm të të pandehurit Hasan Halit Dedja, për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/4 i K.Penal.
- Heqjen e masës së sigurimit për të pandehurin Hasan Dedja.
- Shpenzimet proceduriale të hetimit dhe gjykimit sikurse janë kryer.
- Kunder vendimit lejohet rekurs sipas ligjit në Gjykatën e Lartë.

KANCELARE

DONALDA FERUNI